



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:056753

Datë: 05.10.2023

Numri i dokumentit: 04759319

PPP.nr.67/19

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, si gjykatë e shkallës së parë, me gjyqtarin Blerand Rrmoku, në çështjen juridike përmbartimore ndërmjet kreditores V.G nga fshati LL, Komuna G, të cilën në bazë të autorizimit e përfaqëson G.H, avokat në G, ndaj debitores KS “E”, me seli në P, lidhur me çështjen përmbartimore përmbushje e borxhit, duke vendosur lidhur me prapësimin e ushtruar nga debitori, kundër Urdhrit për lejimin e përmbartimit P.nr.459/18, të datës 27.12.2018, të lejuar nga Përmbartuesi Privat H.L.H në G, jashtë seancës gjyqësore, me datë 05.10.2023. mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET si i bazuar prapësimi i ushtruar nga debitori KS “E”, me seli në P, ashtu që: ANULOHET Urdhri për lejimin e përmbartimit P.nr.459/18, i datës 27.12.2018, i lejuar nga Përmbartuesi Privat H.L.H në G, si dhe REFUZOHET propozimi për përmbartim i paraqitur me datë 27.12.2018 nga përfaqësuesi i kreditores V.G.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat H.L.H në G, duke vepruar sipas propozimit të përfaqësuesit të autorizuar të kreditores V.G nga fshati LL, Komuna G, ka lejuar përmbartimin në bazë të Urdhrit Përmbartimor P.nr.459/18, të dt.27.12.2018, me të cilin në bazë të marrëveshjes jashtëgjyqësore të dt.06.12.2018, me numër 1485/18/02, e ka obliguar debitorin që të bëjë pagesën e borxhit në shumën prej 565.00 Euro, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Kundër Urdhrit të lartëcekur për lejimin e përmbartimit, brenda afatit të paraparë ligjor, prapësim ka paraqitur debitori. Në prapësimin e ushtruar, ndër tjera pretendohet se marrëveshja jashtëgjyqësore nuk e ka statusin e dokumentit të besueshëm sipas dispozitave të LPP-së, ku janë përcaktuar llojet e dokumenteve mbi bazën e të cilave lejohet përmbartimi, duke e kundërshtuar në këtë mënyrë Urdhërin për Përmbartim. Tutje pretendohet se përmbartuesi privat ka lejuar propozimin për përmbartim pa vërtetuar në mënyrë të drejtë gjendjen faktike dhe pa aplikuar drejtë dispozitat ligjore në fuqi, për faktin se në rastin konkret nuk janë përmbushur kushtet e

përcaktuara për lejimin e përmbarimit. Mbi bazën e këtyre pretendimeve, ka propozuar që të aprovohet në tërësi si i bazuar prapësimi dhe Urdhëri Përmbarimor të anulohet.

Përfaqësuesi i autorizuar i kreditores ka paraqitur përgjigje në prapësimin e ushtruar nga debitori. Në përgjigje në prapësim, ndër tjera theksohet se pretendimet e kreditores që marrëveshja jashtëgjyqësore nuk e ka cilësinë e dokumentit të besueshëm nuk kanë mbështetje në dispozita ligjore, për faktin se në nenin 22 par.1 nënpar 1.2 të LPP-së janë të përcaktuara dokumentet e besueshme, e në rastin konkret kemi një marrëveshje të përpiluar nga vetë pala debitore dhe mbi këtë bazë e njejta është e detyruar në përmbushjen e obligimit ndaj kreditores. Bazuar në këto pretendime, ka propozuar që të refuzohet prapësimi si i pa bazuar.

Gjykata pas vlerësimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, pretendimeve të kreditorit të paraqitura në përgjigje në prapësim si dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar për arsyet në vijim:

Dispozita nga neni 22 e Ligjit për Procedurën Përmbarimore përcakton llojet e dokumenteve përmbaruese (titujve ekzekutiv), mbi bazën e të cilave organi përmbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarimin në kuptim të nenit 21 të LPP-së. Kjo dispozitë parasheh që: *“Dokumente përmbaruese janë: 1.1. vendimi përmbarues i Gjykatës dhe ujdia (pajtimi) gjyqësore përmbaruese; 1.2. vendimi përmbarues i dhënë në procedurë administrative dhe aktpajtimi (më tej: ujdia); 9 1.3. dokumenti noterial i përmbarueshëm në pajtim me ligjin për noterinë; 1.4. marrëveshja e lidhur në procedurën e ndërmjetësimit në pajtim me Ligjin mbi ndërmjetësimin pas aprovimit të Gjykatës; 1.5. aktvendimet, aktet dhe memorandumet për ujdite gjyqësore të Gjykatave të huaja si dhe vendimet e Gjykatave të huaja të arbitrazhit dhe ujdite e arritura para Gjykatave të tilla në raste të arbitrazhit, të cilat janë pranuar për përmbarim brenda territorit të Republikës së Kosovës; 1.6. vendimet dhe marrëveshjet përmbaruese të arbitrazhit në Republikën e Kosovës të shpallura të ekzekutueshme nga Gjykata; 1.7. kontrata për hipotekën e vërtetuar nga organi kompetent dhe regjistruar në regjistrin publik sipas ligjit; 1.8. vendimi gjyqësor i vërtetuar si urdhër përmbarues evropian; 1.9. dokumenti tjetër që me ligj është quajtur dokument përmbarues.”*

Në rastin konkret, organi përmbarues e ka lejuar përmbarimin bazuar në marrëveshjen jashtëgjyqësore të dt..., me numër ..., të lidhur mes palëve të përfshira në këtë procedurë përmbarimore. Gjykata vlerëson se një dokument i tillë nuk bën pjesë në ndonjë prej kategorive të dokumenteve përmbarimore, të numëruara me dispozitën e lartëcekur të nenit 22 të LPP-së dhe si i tillë nuk i përmbushë kriteret e kërkuara për të shërbyer si dokument mbi bazën e të cilit mund të lejohet dhe caktohet përmbarimi.

Gjykata mori parasysh pretendimin e ngritur nga ana e përfaqësuesit të autorizuar të kreditores në përgjigje në prapësim se marrëveshja jashtëgjyqësore paraqet dokument përmbarues në kuptim të nenit 22 par.1 nënpar 1.2 të LPP-së, dispozitë e cila i referohet *“vendimit përmbarues të dhënë në procedurë administrative dhe aktpajtimit (më tej: ujdia)”*. Interpretimi i Gjykatës konsiston në faktin se dispozita e lartëcekur e kërkon që përveç vendimit përmbarues të dhënë në procedurë administrative edhe aktpajtimi (ujdia), duhet të rezultojë pikërisht nga një

procedurë e tillë, e në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me ujdë të kësaj natyre, për faktin se është lidhur pranë një subjekti i cili nuk e ka cilësinë e organit administrativ. Nisur nga rrethanat e tilla, pretendimi i palës kreditore lidhur me përmbareshëmminë e dokumentit është pa mbështetje në dispozitat ligjore në fuqi.

Dispozita nga neni 43 par.4 e LPP-së përcakton se: *“Përmbareshmit privat nxjerrin urdhrin për përmbareshmëri në rastet që ligjërisht prezantohen para tyre të cilat përmbushin kushtet për përmbareshmëri. Në lidhje me ankesën që ngrehë kundërshtimin ndaj urdhrin të përmbareshmërisë së nxjerrë nga përmbareshmit privat, Gjykata që kryen rishikimin e procedurës së përmbareshmit rishikon nëse janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e atij urdhri nga përmbareshmit privat. Nëse Gjykata përcakton se nuk janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e urdhrin për përmbareshmit nga përmbareshmit privat, Gjykata shfuqizon urdhrin me vendim”*. Mbi këtë bazë, gjykata në rastin konkret vlerëson se nuk janë plotësuar kushtet ligjore për nxjerrjen e urdhrin për lejimin e përmbareshmit nga përmbareshmit privat, sepse është lejuar përmbareshmit mbi bazën e një dokumenti i cili rezulton se nuk e ka cilësinë e dokumentit përmbareshmit (titullit ekzekutiv), andaj duke iu referuar dispozitës së lartëcekur, gjeti se pretendimet e parashtruara në prapësimin e debitorit janë të bazuara, rrjedhimisht vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, duke e shfuqizuar Urdhërin për lejimin e Përmbareshmit.

Mbi bazën e arsyeve të elaboruara më sipër, në mbështetje të nenit 73 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
PPP.nr.67/19, datë 05.10.2023

Gjyqtari,
Blerand Rrmoku

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimin të të njëjtit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës, përmes kësaj gjykate.